

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P. Nr.: 123/13

Data: 6 shtator 2013

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në PRIZREN me Trupin Gjykues të përbërë nga Kryetari i Trupit Gjykues në EULEX Vitor Hugo Pardal, Gjykatësja nga EULEX Anna Adamska Gallant dhe gjykatësi vendor Skender Çoçaj në cilësinë e anëtarëve të trupit gjykues, të asistuar nga asistenti nga EULEX Eduard Nimani dhe proces-mbajtësja Christine Sengl, në lëndën penale ndaj:

OK.A, i biri i dhe, i lindur më në, ..,, .., .., me vendbanim në, .., .., .., .., .., në gjendje të,,, pasaportë ... nr. dhe letërnjoftimi i Kosovës nr.;

BU.F, i biri i ... dhe, i lindur më në, ..,, .., me vendbanim në, .., .., .., .., .., .., .., .., numri i letërnjoftimit;

FL.A, i biri i ... dhe, i lindur më në, .., .., me vendbanim, .., .., .., .., .., .., .., .., numri i letërnjoftimit dhe numri i pasaportës

.....

;

Me aktakuzën e ndryshuar më 11 shkurt 2013, të gjithë të pandehurit akuzohen me **krim të organizuar** në kundërshtim me Nenin 274, paragrafët 1 deri 3, KPK, **kontrabandim me migrantë** në kundërshtim me Nenin 138, paragrafët 1 deri 6 KPK dhe **pastrim parash**, në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit 03/L-196, datë 3 shtator 2010, dhe pjesa 10.2 e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, datë 5 shkurt 2004.

Dy të pandehurit e parë janë akuzuar secili edhe me një pikë **Kontrabandim me migrantë**, përkatësisht në kundërshtim me nenin 138, paragrafët 1 deri 6 dhe 138, paragrafët 1, 3, 5 dhe 6, KPK.

Pas mbajtjes së shtatë seancave të hapura për publikun më 27 mars 2013 (seanca fillestare), 29 dhe 30 prill 2013; 2 maj 2013; 12 qershor 2013, 10 korrik 2013 dhe 20 gusht 2013, me aktgjykimin e shpallur me gojë më **22 gusht 2013** në prani të të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, Z. Ethem Rogova, Z. Hajrip Krasniqi dhe Z. Brahim Sopa, së bashku me Prokurorin nga PSRK Z. Alister Cumming dhe pas pleqërimit dhe votimit të mbajtur më 21 gusht 2013, në pajtim me nenet 362.1, 364 dhe 365, KPPK, nxjerrë si në vijim:

AKTGJYKIM

Akuza 1 – **Krim i organizuar** në kundërshtim me nenin 274, paragrafët 1 dhe 3 dhe 23, KPK, në pajtim me nenet 362.1 dhe 364.1.3, KPPK, të akuzuarit OK.A, BU.F dhe FL.A të gjithë

LIROHEN

Nga akuza e lartpërmendur sepse nuk është vërtetuar se ndonjë nga të akuzuarit kanë kryer veprën apo veprat me të cilat ngarkohen, si në vijim:

“Mes datës 11 maj 2010 dhe datës 14 dhjetor 2011, Ok.A; mes datës 30 nëntor 2010 dhe datës 5 janar 2012 Bu.F; dhe mes datës 6 dhjetor 2010 dhe datës 12 mars 2012 Fl.A në territorin e Kosovës kreu veprën penale krim i organizuar duke a) organizuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga më shumë se vetë ata “; b) kryerja e kontrabandimit me migrantë ishte pjesë e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga më shumë se sa vetë ata; c) pjesëmarrje aktive në aktivitete kriminale apo të tjera të çfarëdo grupi të organizuar kriminal duke e ditur se pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte në kryerjen e ndonjë vepre të rëndë penale nga cilido grup; për të pasur në mënyrë direkte apo indirekte përfitim financiar apo ndonjë përfitim tjetër material”.

Akuza 2 – **Kontrabandimi me migrantë** në kundërshtim me nenin 138, paragrafët 1 dhe 5, KPK, në pajtim me nenet 362.1 dhe 365, KPPK, i pandehuri FL.A

LIROHET

Nga akuza e lartpërmendur sepse nuk është vërtetuar se ky i akuzuar ka kryer veprën apo veprat penale me të cilat është ngarkuar si në vijim:

“Mes datës 25 qershor 2011 dhe datës 14 dhjetor 2011, Fl.A në territorin e Kosovës, Serbisë, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë dhe shteteve të tjera kreu veprën penale Kontrabandim me migrantë duke u përfshirë në kontrabandim, duke gjetur dhe siguruar dokumente të falsifikuara të identitetit apo të udhëtimit për të mundësuar kontrabandimin në mënyrë që të përfitojë financiarisht apo të ketë ndonjë përfitim tjetër material; duke u mundësuar personave që nuk janë shtetas të Kosovës të hyjnë apo të qëndrojnë në Kosovë apo persona që nuk janë shtetas apo banorë të përhershëm, të kalojnë kufirin pa i përmbushur kërkes.për hyrje të ligjshme, dhe të mbeten në shtetin në fjalë pa i përmbushur kërkes.ligjore për qëndrim nëpërmjet mënyrave të cekura më parë apo nëpërmjet mënyrave të tjera të paligjshme; dhe më e rëndësishmja, duke organizuar dhe drejtuar personat e tjerë për të bërë të njëjtën gjë, për migrantët si në vijim:

Mes datës 25 qershor 2011 dhe datës 6 korrik 2011, kontrabandimi i Ha.D, shtetase turke, Fe.Y, shtetas turk dhe Ab.S.Z, shtetas turk nga Turqia nëpërmjet Malit të Zi, Serbisë, Bosnës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë për në Itali.

Mes datës 19 tetor 2011 dhe datës 23 tetor 2011 kontrabandimi i Se.A dhe Ta.T, shtetas turq nga Turqia nëpërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë për në Itali;

Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 7 tetor 2011 kontrabandimi i Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri i shënuar S), shtetas turq nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë për në Slloveni dhe Francë;

Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 17 nëntor 2011, kontrabandimi i Za.A dhe Om.Y, shtetas turq nga Turqia në Kosovë pastaj Turqi nëpërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali;

Mes datës 17 nëntor 2011 dhe datës 20 Nëntor 2011, tentimi i kontrabandimit të 4 migrantëve të paligjshëm dhe të paidentifikuar turq nëpërmjet Malit të Zi dhe Serbisë në Gjermani;

Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 nëntor 2011, tentimi i kontrabandimit të 4 migrantëve në Beograd - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S nga Serbia nëpërmjet Hungarisë në Austri;

Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011, kontrabandimi i familjes së përbërë nga një nënë dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.dhe një djalë tjetër turk, Ug., nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë për në Itali;

Mes datës 18 gusht 2011 dhe datës 3 dhjetor 2011, kontrabandimi dhe apo mundësimi i personave që nuk janë shtetas apo banorë të përhershëm apo që nuk ju lejohet ligjërisht të hyjnë apo të qëndrojnë në shtete të tjera, përkatësisht, 19 persona në pyll - Mu.B, Az.K, Ba.B, Se. apo Ser., Fa.T, Me., Se., Em.U, Me.E, familje prej 3 personave, Me.A, Ta.A, Er.A, Me.Y, Ay.U, Ra.T, Sa.D dhe persona të tjerë të paidentifikuar me origjinë turke nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe apo Bosnjës dhe Hercegovinës për në Slloveni, Itali, Gjermani dhe /apo Austri, në bashkë-kryerje në pajtim me Nenin 23, KPK.”

Lidhur me të akuzuarit OK.A dhe BU.F me të dhënat personale si më lart, Gjykata i shpallë që të dy

FAJTORË

OK.A për shkak se “mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 7 tetor 2011 kontrabandoi Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri S), shtetas turq nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë në Slloveni dhe Francë;

Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 nëntor 2011, tentoi kontrabandimin e 4 migrantëve nga Beogradi - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S nga Serbia nëpërmjet Hungarisë në Austri;

Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011 kontrabandoi një familje që përbëhej nga një nënë dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.dhe një djalë tjetër turk, Ug. nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë në Itali; që të gjitha këto në bashkë-kryerje, sipas nenin 23, KPK;

Mes datës 25 qershor 2011 dhe datës 6 korrik 2011, kontrabandoi Ha.D, shtetase turke, Fe.Y, shtetas turk dhe Ab.S.Z, shtetas turk nga Turqia nëpërmjet Malit të Zi, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali;

Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 17 nëntor 2011, kontrabandoi Za.A dhe Om.Y, shtetas turq nga Turqia në Kosovë dhe pastaj Turqi nëpërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali”.

dhe

BU.F për shkak se “mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 7 tetor 2011 kontrabandoi Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri S), shtetas turq nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë në Slloveni dhe Francë;

Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 nëntor 2011 tentoi kontrabandimin e 4 migrantëve në Beograd - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S nga Serbia nëpërmjet Hungarisë në Austri;

Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011, kontrabandoi një familje që përbëhej nga një nënë dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.dhe një djalë tjetër turk, Ug., nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë në Itali; që të gjitha këto në bashkë-kryerje sipas nenit 23, KPK.”

Që të dyja në kundërshtim të nenit 138, paragrafi 1, KPK-ja e vjetër (2003), duke i liruuar që të dy për të gjitha nën-akuzat e mbetura.

Akuza 3 – **Kontrabandimi me migrantë** në kundërshtim me nenin 138, paragrafët 1 dhe 5, KPK sipas neneve 362.1 dhe 365, KPPK, i pandehuri OK.A

LIROHET

Nga akuza e lartpërmendur sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën apo veprat

me të cilat është ngarkuar si në vijim:

”Mes datës 5 tetor 2011 dhe 9 tetor 2011, Ok.A në territorin e Kosovës kreu veprën penale e kontrabandimit në tentativë me migrantë duke u angazhuar në kontrabandimin; gjetjen dhe sigurimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit apo të identitetit për të mundësuar përfitim financiar apo përfitim tjetër material; dhe mundësimin e personave që nuk janë qytetarë të Kosovës të hyjnë në Kosovë apo persona që nuk janë shtetas apo qytetarë të përhershëm të kalojnë kufirin pa i përmbushur kërkes.për hyrje të ligjshme dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa i përmbushur kërkes.e nevojshme ligjore për të qëndruar nëpërmjet mënyrave të lartpërmendura apo mënyrave të tjera të paligjshme; dhe më e rëndësishmja, duke organizuar dhe duke drejtuar persona të tjerë për të kryer të njëjtën gjë për migrantët si në vijim: Ah. E, Mu.E dhe Ab.E nga Turqia nëpërmjet Kosovës dhe Shqipërisë për në Itali, në bashkë-kryerje në pajtim me nenin 23, KPK”.

Akuza 4 – Kontrabandim me migrantë, në kundërshtim me nenin 138, paragrafët 1 dhe 5, KPK, në pajtim me nenet 362.1 dhe 365, KPPK, i pandehuri BU.F

LIROHET

Nga akuza e lartpërmendur për shkak se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën apo veprat penale me të cilat është ngarkuar si në vijim:

*“Mes datës 26 nëntor 2011 dhe datës 2 dhjetor 2011, Bu.F në territorin e Kosovës, Sllovenisë dhe Austrisë, ka kryer veprën penale Kontrabandim me migrantë duke u angazhuar në kontrabandimin; gjetjen dhe sigurimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit apo identifikimit për të mundësuar kontrabandimin për përfitim financiar apo përfitim tjetër material; dhe mundësimi i personave që nuk janë qytetarë të Kosovës për të hyrë në Kosovë apo personave që nuk janë shtetas qytetarë të përhershëm për të kaluar një kufi pa përmbushur kërkes.për hyrje të ligjshme dhe për të qëndruar në shtetin në fjalë pa i përmbushur kërkes.e nevojshme ligjore për të qëndruar nëpërmjet mënyrave të cekura më parë apo me mënyra të tjera të paligjshme dhe më e rëndësishmja, duke organizuar dhe drejtuar personat e tjerë për të bërë të njëjtën gjë për migrantët si në vijim:
Familje prej 5 anëtarëve – bashkëshorti, bashkëshortja, dhe 3 fëmijë – nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë në Grac të Austrisë në bashkë-kryerje sipas nenit 23, KPK”.*

Akuza 5 –Pastrim parash në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit 03/L-196, të hyrë në fuqi më 18 tetor 2010 dhe pjesa 10.2 e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, datë 5 shkurt 2004, në pajtim me nenet 362.1 dhe 365, KPPK, të akuzuarit OK.A, BU.F dhe FL.A që të gjithë

LIROHEN

Nga akuza e lartpërmendur për shkak se nuk është vërtetuar se ndonjë nga të akuzuarit kanë kryer veprën apo veprat me të cilat ngarkohen si në vijim:

“Mes datës 11 maj 2010 dhe datës 14 dhjetor 2011, Ok.A; mes datës 30 nëntor 2010 dhe datës 8 dhjetor 2011, Bu.F; dhe mes datës 6 dhjetor 2010 dhe datës 8 dhjetor 2011, Fl.A; në territorin e Kosovës dhe shteteve të tjera kanë kryer veprën penale të pastrimit të parave duke e ditur apo duke pasur arsye për të ditur se pasuria, përkatësisht parat e gatshme apo mjete të tjera monetare kanë burimin të aktiviteti kriminal pra krimi (kontrabandim me migrantë nga anëtarët e grupit kriminal):

a) konvertimin apo transferimin, apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pasurinë me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit, dispozicionit, lokacionit, lëvizjen apo pronësinë e pronës;

b) konvertimin apo transferimin, apo tentativën për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të asistimit të ndonjë personi, përkatësisht, Ok.A, Bu.F, Fl.A, Ah. C, Nu.N, 'N', Sh.M, Mu.M, Ar.V, Ke.V, Ni.M, Hu.M, Ka.H, Ar.B, Sa.A, Ri.V, Ga.B, Af.A, Ag.B, Ba.E, Da.M, Ta.H, Ma.B, Da.S, An.S, Ed.S, Mi.M, Ra.A, Ok.S, Ib.B, Mu.T, Mu.G, Hu.G, Me.I, Ha.H, Ha.H, Ja.Z("ir."), Nu.K, Is. (mbiemri i panjohur), Es.(mbiemri i panjohur), Av. (mbiemri i panjohur), Be.(mbiemri i panjohur), personi me emrin "Kl.", dhe anëtarë të tjerë të panjohur të grupit kriminal, të cilët janë të përfshirë në kryerjen e veprës penale që prodhoi pasurinë (kontrabandim me migrantë) për t'u shmangur pasojave ligjore;

c) konvertimin apo transferimin, apo tentativën për të konvertuar apo transferuar pasurinë për qëllim të promovimit të aktivitetit penal në fjalë (kontrabandimi me migrantë); dhe /apo

d) sigurimi, posedimi apo përdorimi i pasurisë (para të gatshme apo mjete të tjera monetare)”.

DËNIMI

Në pajtim me nenin 365.1.3, KPPK, dhe neni 71, KPK, të pandehurit e dënuar me kaq dënohen si në vijim:

I pandehuri **Ok.A për akuzën 2 – Kontrabandim me migrantë** në shkelje të nenit 138, paragrafi 1, KPK, në pajtim me nenet 362.1 dhe 365, KPPK: 7 (shtatë) vjetë burgim;

I pandehuri **Bu.F për akuzën 2 – Kontrabandim me migrantë** në shkelje të nenit 138, paragrafi 1, KPK, në pajtim me nenet 362.1 dhe 365, KPPK: 3 (tre) vjetë burgim;

Për secilin nga të pandehurit Ok.A dhe Bu.F koha e kaluar në paraburgim, përkatësisht nga 14 dhjetor 2011 dhe 17 prill 2012, do të llogaritet.

KONFISKIMI

Me të pasur parasysh provat e administruar gjatë seancave të shqyrtimit kryesor se telefonat mobilë që janë konfiskuar nga të pandehurit e dënuar dhe janë përdorur në kryerjen e veprave penale, gjë për të cilën janë dënuar, konfiskimi përkatës i gjëseneve të tilla me kaq përcaktohet, sipas nenit 283. 1 deri 4 KPPK.

SHPENZIMET

Ok.A dhe Bu.F janë shpallur fajtorë për vepra penale dhe prandaj kanë për obligim të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 451.1 dhe 2 dhe 453.1, KPPK, listuar nga neni 450.2 të kodit të njëjtë përpos shpenzimeve për përkthim përgjatë gjithë procedurës penale. Me të marrë në konsideratë të gjithë dëshmitarët, numrin e seancave të mbajtura, kërkes.për NLN, shuma e shpenzimeve me kaq përcaktohet 2000 (dy mijë) Euro, gjë për të cilën, që të dy të pandehurit janë përgjegjës bashkarisht dhe një nga një.

MASAT KUFIZUESE

Me kaq përfundon arresti shtëpiak ndaj të pandehurit FLA sipas neneve 183.7 dhe 367.4.1, KPPK. Me kaq zgjatet paraburgimi ndaj të pandehurit OK.A deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit sipas nenit 367.2 dhe 7, KPPK.

Zgjatja e mundshme e paraburgimit lidhur me të pandehurin BU.F do të vendoset nga Trupi Gjykes me një vendim të veçantë menjëherë pas shpalljes së këtij aktgjykimi dhe pas dëgjimit të palëve përkatëse sipas nenit 380.1, KPPK.

ARSYETIMI

Historiku procedural

Më 11 dhjetor 2012, prokurori i PSRK-së Z. Alister Cumming ushtroi aktakuzë ndaj 2 personave, Ok.A dhe Bu.F, e cila përmbante prova të dokumentuara (faqe 84 dhe 85 e aktakuzës), dhe 3 dëshmitarë (faqe 84) në mënyrë që të mbështetë akuzën për Krim të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafët 1 dhe 3 të KPK (akuza 1), Kontrabandim me migrantë, në kundërshtim me nenin 138, paragrafët 1 deri në 6 (akuza 2) dhe Pastrim parash, në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit 03/L-196 datë 3 shtator 2010 dhe nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, datë 5 shkurt 2004 (akuza 5), me të cilat akuzohen dy të pandehurit e parë, në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK.

Më 11 shkurt aktakuza pësoi ndryshim dhe tani përfshinë FLAn si të pandehur në Akuzat e lartpërmendura 1, 2 dhe 5, në bashkëkryerje.

Janë paraqitur provat e njëjta lidhur me këtë të pandehur për të mbështetur akuzën për Kontrabandim me migrantë, në kundërshtim me nenin 138, paragrafët 1 deri në 6 dhe me nenin 138, paragrafët 1, 3, 5 dhe 6 të KPK (përkatësisht Akuzat 3 dhe 4) për të cilat i pandehuri i parë dhe i pandehuri i dytë janë akuzuar individualisht.

Janë mbajtur tetë seanca të hapura për publikun, më 27 mars 2013 (shqyrtimi i parë), më 29 dhe 30 prill; më 2 maj 2013; më 12 qershor 2013, 10 korrik 2013, 20 dhe 22 gusht 2013, dhe aktgjykimi është shpallur në seancën e fundit të mbajtur më 22 gusht 2013.

Mbrojtja ngriti disa çështje preliminare në shqyrtimin e parë dhe këto janë shqyrtuar më vonë dhe janë vendosur përmes aktvendimit të datës 25 prill 2013, të shpallur nga Kryetari i Trupit Gjykses. Pas kësaj palët kanë ngritur tre kundërshtime dhe mbi këto është marrë aktvendim: a) kundërshtimi i paraqitur nga Ethem Rugova, i cili përfaqëson të pandehurin Ok.A lidhur me hapjen e procedurës penale në Kosovë, datë 29 prill 2013, u vendos si çështje e mëparshme nga aktgjykimi aktual si më poshtë; b) kundërshtim i provave të reja për t'u paraqitur nga prokuroria

lidhur me shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor, hedhur poshtë përmes aktvendimit të datës 2 maj 2013;
c) papranueshmëria e të gjitha deklaratave lidhur me viktimat e marra në pyetje nga autoritetet e huaja për shkak të pamundësisë së marrjes në pyetje nga pala tjetër siç u deklarua nga prokurori i PSRK-së, datë 10 korrik 2013.

Të gjithë të pandehurit u deklaruan gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, në përputhje me nenet 346 dhe 347 të KPPK, pasi ata u informuan lidhur me deklaratat e secilit prej tyre menjëherë pasi i fundit u mor në pyetje në mungesë të tjetrit, në përputhje me nenin 345.3 të KPPK.

Prokurori e dha fjalën e tij përfundimtare dhe të gjithë të pandehurit paraqitën fjalët e tyre përfundimtare vet ose/dhe nga avokatët e tyre përkatës.

Të gjithë të pandehurit kanë qenë të pranishëm gjatë shpalljes së aktgjykimit përfundimtar.

Juridiksioni i gjykatës

Gjykatësit e këtij Trupi Gjykues janë kompetentë të gjykojnë këtë lëndë ngase kanë kompetenca materiale dhe territoriale, në pajtim me nenet 25 dhe 29 të KPPK; si rrjedhojë e vendimit të Kryetarit të Gjykatësve të EULEX-it nxjerrë më 11 mars 2013 për të caktuar gjykatësit e EULEX-it të nënshkruar më poshtë të gjykojnë këtë lëndë, është caktuar gjykatësi vendor sipas orarit në fuqi në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Janë mbajtur shtatë seanca të shqyrtimit gjyqësor dhe nuk janë ngritur kundërshtime nga palët. Prandaj, Trupi Gjykues është kompetent në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit mbi kompetencat (Ligji 03/L-53).

Çështja e mëparshme: “bashkëndërgjyqësia” e procedurës penale në Kosovë

Gjatë fjalës së tij përfundimtare, Z. Ethem Rugova, ngriti kundërshtimin si në vijim:

“kjo procedurë është në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-31, datë 16/09/2011, që ka të bëjë me transferimin e procedurës penale nga shtetet e huaja për në Kosovë sepse kushtet nuk janë përmbushur siç parashihet me dispozitat e këtij ligji. Është shumë e rëndësishme të përmendet se procedura e lartpërmendur filloi në kundërshtim me nenin 117, Kodi Penal i Kosovës, dispozitë e cila parasheh kushte speciale për ndjekjen penale të veprave penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë, në mesin të tjerash, parasheh në paragrafin 1 se “në raste të parapara, neni 114 i këtij kodi, nëse procedura penale ka filluar, por, nuk ka mbaruar në juridiksion tjetër, procedura penale në Republikën e Kosovës do të fillojë vetëm me aprovimin Kryeprokurorit të Republikës së Kosovës”. Një dokument i tillë nuk është prezantuar as gjatë shqyrtimit kryesor e as nuk gjendet në dosjen e lëndës.

Trupi Gjykses gjen se ky argument nuk është i bazuar. Aktakuza është ushtruar në gjykatë fillimisht më 11 dhjetor 2012, pra para hyrjes në fuqi të kodit të ri. Prandaj, çdo dispozitë procedurale lidhur me fillimin e procedurës penale duhet t'i referohet asaj dite dhe prandaj, KPK-së në fuqi në atë kohë.

Duke pasur parasysh këtë, sipas nenit 103.1, KPK (2003), aprovimi duhet marrë nga Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës. Me KPK-në e re, është me autorizimin e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.

Prokurori Publik i Kosovës nuk definohet si i tillë në ligjin e ri për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.03/L –225), i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013, por neni 32.2 është i qartë dhe lexon: “me hyrjen në fuqi të këtij ligji, çdo referim ndonjë ligji, rregulloreje, direktiva, rregulli apo ndonjë akti tjetër ligjor ndaj “shërbimeve të prokurorit” apo “Prokurorit Publik” do të interpretohet si “prokurorit të shtetit”.

Prokurori definohet sipas nenit 2.1.1 të ligjit të njëjtë si “institucioni i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar me kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera të përcaktuara në ligj dhe përfshin si në vijim: Prokuroria Themelore; Prokuroria e Apelit; Prokuroria Speciale; dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit; ...”

Prandaj, para datës 1 janar 2013, i vetmi autorizim që nevojitej ishte nga Prokuroria Publike (e shtetit) dhe jo nga ndonjë autoritet më i lart i të njëjtit institucion siç është tani (Kryeprokurori i Shtetit në Republikën e Kosovës).

Nuk do të ishte e logjikshme të kërkohej me ngulm një autorizim formal i dokumentuar nga dikush që ishte (dhe vazhdon të jetë) pjesë e Prokurorisë Publike, përkatësisht Prokurori nga PSRK, i cili ngriti aktakuzën në fjalë. Prandaj, ky kundërshtim duhet të konsiderohet si proceduralisht i pabazuar dhe nuk ka kundërshtime materiale apo procedurale që e parandalojnë Trupin Gjykes për të futur meritat e kësaj çështje në lëndë.

Provat e administruara

Provat në vijim janë konsideruar relevante për pleqërimin përfundimtar dhe aktgjykimin pasues.

Provat me shkrim: Lista vijuese e provave të dokumentuara është konsideruar si e analizuar gjatë shqyrtimit kryesor, siç parashihet me nenin 344.1, KPPK:

- Raporte 15-ditëshe për numrin e telefonit 0038XX, datë 29 gusht 2011, 13 shtator 2011, 29 shtator 2011 dhe 14 tetor 2011;
- MPB — raporti nga Agjencia e Regjistrimit Civil, datë 5 dhjetor 2011;
- Raporte 15-ditëshe në numrin e telefonit 0038XX, datë 6 dhjetor 2011, 21 dhjetor 2011, 18 shkurt 2012, 4 mars 2012, 19 mars 2012 dhe 2 prill 2012;
- Raporte 15-ditëshe për numrin e telefonit 0038XX, datë 12 dhjetor 2011, 29 dhjetor 2011, 13 janar 2012, 4 mars 2012 dhe 19 mars 2012;
- Raporte me transkribime të përgjimeve të ligjshme — periudhat 8 nëntor 2011 deri 21 nëntor 2011, 22 nëntor 2011 deri 6 dhjetor 2011, datë 14 dhjetor 2011;
- Raporte për bastisje të banesës së Ok.A, datë 15 dhjetor 2011 dhe Fl.A, datë 19 dhjetor 2012;

- Raporte për përgjime të ligjshme — periudha 22 nëntor 2011 deri 7 dhjetor 2011, datë 15 shkurt 2011;
- Regjistrimi i numrave të telefonit, raporte të policisë, datë 15 dhjetor 2011 dhe 3 maj 2012;
- Raporti për vëzhgim nga policia e EULEX-it, datë 17 janar 2012;
- Raporte të policisë së EULEX-it, datë 2 shkurt 2012, 22 shkurt 2012, 10 maj 2012, 3 korrik 2012 dhe 4 tetor 2012
- Raporti i provave + CD, datë 10 maj 2012;
- Raporte 15-ditëshe për numrin e telefonit 0038XX dhe IMEI n35828703425194, datë 12 dhjetor 2011, 26 shkurt 2012 dhe 11 mars 2012;
- Raporte 15-ditëshe për numrin e telefonit 0038XX, datë 18 shkurt 2012, 5 mars 2012, 19 mars 2012 dhe 2 prill 2012;
- Raporti nga policia e EULEX-it, datë 29 shkurt 2012, 1 mars 2012, 2 mars 2012, 7 mars 2013, 12 mars 2012, 6 prill 2012, 12 prill 2012, 19 mars 2012 dhe 17 korrik 2012;
- Raporte 15-ditëshe për numrin e telefonit 0038XX, datë 8 mars 2012 dhe 23 mars 2012;
- Raporti analizë për provat e konfiskuara, datë 21 mars 2012;
- Raporte 15-ditëshe për numrin e telefonit 0038XX, datë 30 mars 2012 dhe 18 prill 2012;
- Raporti përmbledhës për hetime financiare, datë 9 shtator 2011 dhe 17 shtator 2012;
- Të dhënat financiare të zbuluara nga Banka Raiffeisen, datë 31 gusht 2011 dhe 6 gusht 2012, ProCredit Banka, datë 5 shtator 2011 dhe 4 gusht 2012 + CD, Banka Ekonomike, datë 2 shtator 2011 dhe 1 gusht 2012, NLB, datë 22 gusht 2011 dhe 27 korrik 2012 + CD, BpB, datë 1 shtator 2011 dhe 6 gusht

2012, BKT, datë 22 gusht 2011 dhe 30 korrik 2012, TEB, datë 22 gusht 2011 dhe 27 korrik 2012, UFP, datë 24 gusht 2011 dhe 30 korrik 2012 + CD; DMTH, datë 31 gusht 2011 dhe 2 gusht 2012;

- Raporti nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, datë 26 gusht 2011, 27 gusht 2012 dhe 6 gusht 2012;
- Raporti nga Administrata Tatimore e Kosovës, datë 1 shtator 2011;
- Raporti nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare, datë 1 shtator 2011 dhe 6 shtator 2012;
- Raporti nga Doganat e Kosovës, datë 24 gusht 2011 dhe 31 korrik 2012;
- Raporti Agjencisë për Regjistrim Civil, datë 31 gusht 2011 dhe 24 gusht 2012;
- Akuzat ndaj Ok.A, të pranuar nga NLN nga Sllovenia, datë 21 qershor 2011;
- Raporti i operacionit Okan, të pranuar nga NLN nga policia shtetërore italiane, nga shkurti 2011 në gusht 2012;
- Provat e pranuar nga NLN në Itali si në vijim:
 - Raporti i policisë nga policia kufitare në Triestë, datë 23 shtator 2011 lidhur me dy migrantët turq, të arrestuar në Triestë;
 - Kopje e një marrëveshje në mes të qeverisë së Italisë dhe Sllovenisë lidhur me kthimin e këtyre dy migrantëve në Slloveni;
 - Një biletë treni për dy të rritur nga Triesta në Milan;
 - Raporti nga policia kufitare italiane autoriteteve sllovene me përshkrim të arrestimit të dy migrantëve, gjithashtu duke iu referuar edhe faktit se telefoni është gjetur në posedim të Ta.K, me numrin 0038XX, pronë e Ok.A.
 - Raporti i analizës së aparateve të telefonit të Ta.K dhe Ser. A;
 - Raporte të arrestimit të Ar.V, Er.Z, Fe.Y, datë 5 korrik 2011;
 - Konfiskimi i dokumenteve nga Fe.Y;
 - Procesverbal i bastisjes së personit dhe veturës së Ar.Vt;
 - Transkribimi i thirrjeve telefonike, datë 5 dhe 8 korrik 2011 dhe përmbledhje e transkribimit të thirrjeve të përgjuara telefonike, datë 12 korrik 2011;

- Analizë e të dhënave telefonike, datë 7 korrik 2011; dhe raporti i analizës së telefonit të dy telefonave të Fe.Y, datë 7 korrik 2011

Dëshmitarët: deklaratat e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor nga Mi.J dhe Ka.G.

Deklaratat e të pandehurve: të dhëna Trupit Gjykues gjatë shqyrtimit kryesor.

Bazat

Bazat faktike:

- Faktet relevante në vijim janë konsideruar si të VËRTETUARA:*
 - Mes të datës 25 qershor 2011 dhe datës 6 korrik 2011, Ok.A kontrabandoi Ha.D, Fe.Y dhe Av.S.Z, që të gjithë qytetarë turq nga Turqia nëpërmjet Malit të Zi, Serbisë, Bosnës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali, duke ua mundësuar, duke mos qenë këta qytetarë dhe banorë të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa i përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 1)*
 - Në veçanti: a) të lartpërmendurit 3 individë kaluan kufirin e Italisë dhe më 5 qershor 2011 janë arrestuar më vonë në Trieste për hyrje të paligjshme në Itali, së bashku me Ar.Vn dhe Ba.En; b) 3 individët referohen në biseda telefonike duke përfshirë Ok.A dhe 2 individë të tjerë - Ar.V dhe Ba.E; c) Ok.A përmendet në librin telefonik të njërit nga aparatet e konfiskuara të telefonit; d) në bisedat e tij telefonike, Ok.A u referohet qartë detaleve të udhëtimit, të hollave dhe pagesave direkte lidhur me kontrabandimin e këtyre 3 individëve; e) më 4 korrik 2011, Bu.F i dërgoi 1917,50 Euro Ar.Vt; f) më 13 maj 2011, Fl.A pranoi 4.328,00 Euro, më 31 maj 2011 pranoi 500,00 Euro dhe më 3 qershor 2011, pranoi 3.150,00 Euro gjithnjë nga individë turq;*
 - Më 23 tetor, migrantët Ser. A dhe Ta.T, qytetarë turq janë ndaluar nga policia sllovene në Koper për kalim të paligjshëm të kufirit në mes të Sllovenisë dhe Italisë (nën-akuza 2)*

4. Në veçanti: a) migrantët e lartpërmendur i dërguan porosi SMS dhe telefonata Ok.A; b) më 19 tetor 2011, Bu.F dërgoi 2,777.00 Euro Ka.H, Slloveni; më 20 tetor 2011, pranoi 300 Euro nga Ra.C, Turqi; më 21 tetor 2011 pranoi 1,345.00 Euro nga Ar.C, Shqipëri dhe dërgoi 952.00 Euro Ar.Vt, Slloveni;
5. Në mes datave 1 tetor 2011 dhe 7 tetor 2011 Ok.A dhe Bu.F në bashkë-kryerje kontrabandoi Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri i shënuar S), qytetarë turq nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë në Slloveni dhe Francë duke ua mundësuar, se duke mos qenë qytetarë dhe banorë të përhershëm të Sllovenisë të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme të ligjshme (nën-akuza 3);
6. Në veçanti: a) Ok.A është pajisur me detalet e këtyre migrantëve, është pajtuar mbi çmimin, udhëzoi migrantët me rrugën e planifikuar, i këshilloi lidhur me praninë e policisë në Kroaci (“shumë polici në Zagreb”); b) Ok.A ujdisi një dhomë për ta me telefon në Porec; c) Bu.F raportoi te Ok.A për udhëtimin të nesërmen dhe është udhëzuar nga i fundit; d) Bu.F udhëzoi migrantët të hedhin pasaportat e tyre, sikurse bëri Ok.A, dhe koordinoi shoferët; e) më 19 tetor 2011, Bu.F transferoi 2,777.00 Euro Ka.H në Slloveni dhe më 21 tetor 2011 Bu.F transferoi 952,00 Euro Ar.Vt në Slloveni.
7. Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 17 nëntor 2011, Ok.A kontrabandoi Za.A dhe Om.Y, qytetarë turq nga Turqia në Kosovë pastaj Turqi nëpërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali duke u mundësuar, se duke mos qenë shtetas apo qytetarë të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa i përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 4);
8. Në veçanti: a) Ok.A është pajisur me detalet e këtyre migrantëve; b) më 15 nëntor 2011 bisedoi me njërin nga këta migrantë dhe pagës gjithashtu janë diskutuar me një individ me emrin “Ha.” dhe një pagesë është pranuar nga Ok.A; c) migrantët kaluan kufirin në Itali rreth 16:41 më 16 nëntor 2011; d) më 15 nëntor 2011 Bu.F dërgoi 1.958,50 Euro Ha.At; e) më 20 tetor 2011, Bu.F pranoi 300 Euro nga Ra.C, Turqi dhe më 21 tetor 2011 pranoi 1.345,00 Euro nga Ar.C, Shqipëri;
9. Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 nëntor 2011, Ok.A dhe Bu.F, në bashkë-kryerje në bashkë-kryerje tentuan kontrabandimin e 4 migrantëve në Beograd - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S- nga Serbia nëpërmjet Hungarisë në Austri me qëllim që t’u mundësonte, duke mos qenë shtetas apo banorë të

përhershëm të Austrisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 6);

10. Në veçanti: a) *Ok.A është pajisur me detalet e këtyre migrantëve, është pajtuar mbi çmimin, ujditur me shoferët; c) Bu.F është informuar nga Ok.A lidhur me katër migrantët dhe është informuar mbi identitetin e tyre nëpërmjet SMS-it të dërguar atij nga Ok.A; e) Fl.At i janë dërguar detalet e 3 migrantëve me SMS;*
11. *Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011, Ok.A dhe Bu.F, në bashkë-kryerje kontrabanduan një familje që përbëhej nga një nënë dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.dhe një djalë tjetër turk, Ug., nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë në Itali, duke u mundësuar, duke mos qenë këta shtetas apo qytetarë të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 7);*
12. Në veçanti: a) *Ok.A është pajisur me detalet e këtyre migrantëve, është pajtuar mbi çmimin, udhëzoi migrantët për rrugën e planifikuar për të marrë autobus nga Zagrebi në Porec; c) Bu.F organizoi shoferët nga Porec në Udine; c) pagesa e Il. arriti shumën e 1,700.00 Euro dhe shërbimi i shoferëve është ujditur nga Bu.F me Shk.Mn; d) Bu.F udhëzoi migrantët të hedhin pasaportat e tyre, e) migrantët janë zënë në Venedik më 5 dhjetor 2011 nga policia italiane dhe kthyer në Turqi më 13 dhjetor 2011.*
13. *Trasfertet vijuese me të holla janë vërtetuar se i janë dërguar:*
 - a. *Ok.Ait:*
 - i. *20 shtator 2010, 300 Euro nga Hu.G, Turqi;*
 - ii. *6 tetor 2010, 100 Euro nga Ha.K, Turqi;*
 - iii. *23 tetor 2010, 1900 Euro nga Si. S, Turqi;*
 - iv. *23 tetor 2010, 1300 Euro nga Al. U, Turqi;*
 - v. *15 nëntor 2010, 180 Euro nga Me.I, Turqi;*
 - vi. *14 janar 2011, 1100 Euro nga Er. S, Turqi;*
 - vii. *14 mars 2011, 2500 Euro nga Er. D, Turqi;*
 - viii. *25 maj 2011, 2900 Euro nga Ab. K, Turqi;*
 - ix. *3 qershor 2011, 1525 Euro nga Me.I, Turqi;*
 - x. *24 prill 2011, 4000 Euro nga Me.I, Turqi;*
 - xi. *1 gusht 2011, 2000 Euro nga Ib.B, Turqi;*
 - xii. *2 gusht 2011, 1000 Euro nga Ib.B, Turqi;*
 - xiii. *22 gusht 2011, 3500 Euro nga Ib.B, Turqi;*

- xiv. 11 maj 2010, 100 Euro nga Ha. H, Gjermani;
- xv. 20 tetor 2010, 630 Euro nga Okk. S, Itali;
- xvi. 20 tetor 2010, 1900 Euro nga Mu.T, Itali;
- xvii. 6 dhjetor 2010, 3300 Euro nga Ya. D, Francë;
- xviii. 23 shtator 2011, 3000 Euro nga Me. K, Turqi;
- xix. 14 nëntor 2011, 300 Euro nga Mu. Y, Turqi;
- xx. 16 nëntor 2011, 1850 Euro nga At. V, Turqi;

b. Bu.Ft:

- i. 26 shkurt 2011, 1895,50 Euro nga Al. E, Turqi;
- ii. 31 mars 2011, 3900 Euro nga Oz. K, Turqi;
- iii. 4 prill 2011, 4000 Euro nga Me. I, Turqi;
- iv. 22 gusht 2011, 1800 Euro nga Ce. B, Turqi;
- v. 25 gusht 2011, 1800 Euro nga Ib.B, Turqi;
- vi. 20 Out 2011, 300 Euro nga Ra.C, Turqi;
- vii. 4 nëntor 2011, 450 Euro nga Me. K, Turqi;
- viii. 18 mars 2011, 956 Euro nga Ar.V, Slloveni;
- ix. 4 tetor 2011, 80 Euro nga Su. P, BdhH;
- x. 21 tetor 2011, 1345 Euro nga Ar.C, Shqipëri;
- xi. 17 nëntor 2011, 80 Euro nga Ha. K, BdhH

c. Nga Bu.F për Ar.Vn, Slloveni:

- i. 24 nëntor 2011, 700 Euro;
- ii. 25 mars 2011, 2875 Euro;
- iii. 13 maj 2011, 2298 Euro;
- iv. 26 maj 2011, 1000 Euro;
- v. 2 qershor 2011, 1918 Euro;
- vi. 4 korrik 2011, 1917,50 Euro;
- vii. 21 Out 2011, 952 Euro;

d. Të tjerët nga Bu.F në Slloveni:

- i. 14 korrik 2011, 1727,50 Euro Sh.Mt;
- ii. 24 shtator 2011, 2050 Euro Ru. Bt;
- iii. 19 tetor 2011, 2777 Euro Ka.Hit;

- iv. 15 nëntor 2011, 1968,50 Euro Ha.At;
- v. 8 dhjetor 2011, 200 Euro Ga.Bt;
- vi. 30 nëntor 2010, 500 Euro La. Vt;
- vii. 28 dhjetor 2010, 700 Euro La. Vt;
- viii. 24 janar 2011, 300 Euro La. Vt;
- ix. 14 mars 2011, 800 Euro La. Vt;

e. *FLAt:*

- i. 23 dhjetor 2010, 3450 Euro nga Me.I, Turqi;
- ii. 29 dhjetor 2010, 600 Euro nga Ta. Y, Turqi;
- iii. 15 mars 2011, 1900 Euro nga Ki. S, Turqi;
- iv. 25 mars 2011, 3000 Euro nga Ki. S, Turqi;
- v. 6 prill 2011, 2000 Euro nga Os. E, Turqi;
- vi. 7 prill 2011, 1896 Euro nga Ib.B, Turqi;
- vii. 13 maj 2011, 4328 Euro nga Ys. T, Turqi;
- viii. 31 maj 2011, 500 Euro nga Ib.B, Turqi;
- ix. 3 qershor 2011, 3150 Euro nga Ib.B, Turqi;
- x. 6 dhjetor 2010, 3300 Euro nga Ay. C, Francë;
- xi. 30 nëntor 2011, 200 Euro nga Qe. K, Zvicër;

f. *Nga FLA:*

- i. 23 dhjetor 2010, 500 Euro për Ab. M, Slloveni;
- ii. 14 janar 2011, 500 Euro për Mu.M, Slloveni;
- iii. 4 shkurt 2011, 500 Euro për Ky. M, Turqi;
- iv. 8 dhjetor 2011, 179 Euro për Sa. G, Turqi;

b. Faktet relevante vijuese janë konsideruar si JO TË VËRTETUARA:

14. Mes datës 25 qershor 2011 dhe datës 6 korrik 2011 Bu.F dhe/apo FLA bashkëpunuan në bashkë-kryerje me Ok.A në kontrabandimin e Ha.D, Fe.Y dhe Av.S.Z, që të gjithë qytetarë turq nga Turqia nëpërmjet Malit të Zi, Serbisë, Bosnës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali duke u

- mundësuar, duke mos qenë këta shtetas apo banorë të përhershëm të Italisë, që të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 1).*
15. *Mes datës 19 tetor 2011 dhe datës 23 tetor 2011 Bu.F dhe /apo Fl.A dhe /apo Ok.A kontrabanduan Se.A dhe Ta.T, qytetarë turq nga Turqia nëpërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali (nën-akuza 2);*
16. *Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 7 tetor 2011, Fl.A bashkëpunoi në bashkëkryerje me Ok.A dhe Bu.F, në kontrabandimin e Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri i shënuar S), qytetarë turq nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë në Slloveni dhe Francë duke u mundësuar, duke mos qenë këta shtetas apo banorë të përhershëm të Sllovenisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 3);*
17. *Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 17 nëntor 2011, Bu.F dhe /apo Fl.A bashkëpunuan në bashkëkryerje me Ok.A në kontrabandimin e Za.A dhe Om.Y, qytetarë turq nga Turqia në Kosovë dhe pastaj Turqi nëpërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali, duke u mundësuar, duke mos qenë këta shtetas apo banorë të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 4);*
18. *Në veçanti nuk është vërtetuar se: a) Bu.F ujdisi transportin e migrantëve të lartpërmendur në Evropë; b) Bu.F koordinoi shoferët dhe ujdisi që migrantët të merreshin në Slloveni dhe të dërgoheshin në Udine, Itali. Faktet që kanë të bëjnë me Fl.A nuk janë vërtetuar.*
19. *Mes datës 17 nëntor 2011 dhe datës 20 nëntor 2011, Bu.F dhe /apo Fl.A dhe /apo Ok.A tentoi kontrabandimin e 4 migrantëve të paidentifikuar turq nga Turqia nëpërmjet Mali të Zi dhe Serbisë në Gjermani duke tentuar t'u mundësonte, duke mos qenë këta shtetas apo qytetarë të përhershëm të Gjermanisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 5);*
20. *Në veçanti, nuk është vërtetuar se ndonjë nga të pandehurit ka kryer ndonjë veprë konkrete të kontrabandimit që mund të konfirmohet me çkado tjetër përpos me përgjimet telefonike;*
21. *Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 nëntor 2011, Fl.A bashkëpunoi me Ok.A dhe Bu.F në tentativë për të kontrabanduar 4 migrantë në Beograd - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S- nga Serbia nëpërmjet Hungarisë në Austri, me qëllim të mundësimin të tyre, duke mos qenë këta shtetas apo qytetarë të*

përhershëm të Austrisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore (nën-akuza 6);

- 22. Në veçanti, nuk është vërtetuar se Fl.A ishte në dijeni të çfarëdoj gjëje përveç të dhënave të 3 migrantëve që i ishin dërguar me SMS;*
- 23. Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011, Fl.A kishte bashkëpunuar me Ok.A dhe Bu.Fn për kontrabandimin e një familjeje që përbëhej nga një nënë dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.dhe një djalë tjetër turk, Ug., nga Kroacia përmes Sllovenisë në Itali, duke i mundësuar ata, duke mos qenë shtetas dhe banues të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa përmbushur kërkesat ligjore të domosdoshme (nën-akuza 7);*
- 24. Në veçanti, nuk është vërtetuar se Fl.A ishte përfshirë në faktet përshkruar në nën-akuzën 7;*
- 25. Mes datës 18 gusht 2011 dhe datës 03 dhjetor 2011, Bu.F dhe/ose Fl.A dhe/ose Ok.A kontrabanduan dhe/ose u mundësuan personave të cilët nuk janë shtetas apo banues të përhershëm, ose të cilët nuk lejoheshin të kalonin në mënyrë ligjore, të hyjnë apo të qëndrojnë në shtete të tjera, përkatësisht, 19 persona në pyll, Mu.B, Az.K, Ba.B, Se. ose Ser., Fa.T, Me., Se., Em.U, Me.E, familje prej 3 personash, Me.A, Ta.A, Er.A, Me.Y, Ay.U, Ra.T, Sa.D, dhe persona të tjerë të paidentifikuar me origjinë turke nga Turqia përmes Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe ose Bosnjës dhe Hercegovinës për në Slloveni, Itali, Gjermani dhe /ose Austri (nën-akuza 8);*
- 26. Mes datës 5 tetor 2011 dhe datës 9 tetor 2011, Ok.A në territorin e Kosovës, ka kryer veprën penale të Kontrabandimit me Migrantë në tentativë duke u përfshirë në kontrabandim; duke gjetur dhe siguruar dokumente udhëtimi apo identifikimi të falsifikuara për të mundësuar kontrabandimin për të siguruar përfitim financiar apo material; dhe duke u mundësuar personave të tjerë që nuk janë banorë të Kosovës të hyjnë në Kosovë, apo personave që nuk janë shtetas apo banues të përhershëm për të kaluar kufirin pa përmbushur kërkesat për hyrje të ligjshme dhe për të qëndruar në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat ligjore përmes mënyrave të përmendura më lart apo mënyrave të tjera të paligjshme; dhe ajo që është më e rëndësishme duke organizuar dhe drejtuar persona të tjerë për të kryer të njëjtën gjë për*

- migrantët vijues: Ah. E, Mu.E dhe Ab.E nga Turqia përmes Kosovës dhe Shqipërisë në Itali, në bashkëveprim (akuza 3);
27. Mes datës 26 nëntor 2011 dhe datës 2 dhjetor 2011, Bu.F, në territorin e Kosovës, Sllovenisë dhe Austrisë, ka kryer veprën penale të Kontrabandimit me Migrantë duke u përfshirë në kontrabandim; duke gjetur dhe siguruar dokumente udhëtimi apo identifikimi të falsifikuara për të mundësuar kontrabandimin për të siguruar përfitim financiar apo material; dhe duke u mundësuar personave të tjerë që nuk janë banues të Kosovës të hyjnë në Kosovë, apo personave që nuk janë shtetas apo banorë të përhershëm për të kaluar kufirin pa përmbushur kërkesat për hyrje të ligjshme dhe për të qëndruar në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat ligjore përmes mënyrave të përmendura më lart apo mënyrave të tjera të paligjshme; dhe ajo që është më e rëndësishme duke organizuar dhe drejtuar persona të tjerë për të kryer të njëjtën gjë për migrantët vijues: familje prej 5 personash- bashkëshorti, gruaja dhe 3 fëmijë – nga Kroacia përmes Sllovenisë në Grac, Austri në bashkëkryerje (akuza 4);
28. Mes datës 11 maj 2010 dhe datës 14 dhjetor 2011 Ok.A; mes datës 30 nëntor 2010 dhe datës 5 janar 2012 Bu.F; dhe mes datës 6 dhjetor 2010 dhe datës 12 mars 2012 Fl.A në territorin e Kosovës kanë kryer veprën penale krimi i organizuar duke a) organizuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e një grupi kriminal të organizuar i cili përbëhet nga më shumë persona se vetëm nga ata ; b) kontrabanduar migrantë si pjesë e një grupi kriminal të organizuar që përbëhet nga më shumë persona se vetëm nga ata; c) marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete kriminale apo të tjera të një grupi kriminal të organizuar duke ditur që pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte në kryerjen e krimeve të tjera nga grupe të tjera; me qëllimin për të siguruar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, përfitim financiar apo material (akuza 1).
29. Në veçanti, nuk është vërtetuar se ndonjë nga të pandehurit janë vetë grup i organizuar kriminal apo se kanë vepruar duke vërtetuar se janë pjesë e e ndonjë grupi tjetër kriminal të organizuar .
30. Mes datës 11 maj 2010 dhe datës 14 dhjetor 2011, Ok.A; mes datës 30 nëntor 2010 dhe datës 8 dhjetor 2011, Bu.F; dhe mes datës 6 dhjetor 2010 dhe 8 datës dhjetor 2011, Fl.A; në territorin e Kosovës dhe shtete të tjera kanë kryer veprën penale të Pastrimit të Parave duke ditur apo duke patur arsye të dinë

se disa pasuri të caktuara, përkatësisht para të gatshme apo mjete të tjera monetare, janë rezultat i aktivitetit kriminal, dhe pasuri të cilat në fakt janë përfitime të ardhura nga krimi (kontrabandimi i migrantëve nga anëtarët e një grupi kriminal): a) konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pasurinë për qëllimin e fshehjes së natyrës, burimit, vendit, sistemimin, lëvizjen apo pronësinë e pasurisë; b) duke konvertuar apo transferuar, apo duke tentuar të konvertojnë apo transferojnë, pasurinë me qëllimin për të ndihmuar ndonjë person - përkatësisht, Ok.A, Bu.F, Fl.A, Ah. C, Nu.N, 'N', Sh.M, Mu.M, Ar.V, Ke.V, Ni.M, Hu.M, Ka.H, Ar.B, Sa.A, Ri.V, Ga.B, Af.A, Ag.B, Ba.E, Da.M, Ta.H, Ma.B, Da.S, An.S, Ed.S, Mi.M, Ra.A, Ok.S, Ib.B, Mu.T, Mu.G, Hu.G, Me.I, Ha.H, Ha.H, Ja.Z("Ir."), Nu.K, Is. (mbiemri i panjohur), Es.(mbiemri i panjohur), Av. (mbiemri i panjohur), Be.(mbiemri i panjohur), personi me pseudonimin "Kl.", dhe anëtarë të tjerë të paidentifikuar të grupit kriminal- të cilët janë të përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka prodhuar pasurinë (kontrabandimi i migrantëve) për të shmangur pasojat ligjore; c) konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të promovimit të vetë aktivitetit kriminal (kontrabandimit të migrantëve);dhe/ose d) Marrja, posedimi apo përdorimi i pasurisë (të holla të gatshme apo mjete të tjera monetare) – (akuza 5).

31. Në mënyrë të veçantë nuk është vërtetuar se ndonjë nga të pandehurit ka konvertuar apo transferuar apo se ka tentuar të konvertojë apo transferojë vlerën e të hollave marrë nga apo dërguar te personat/ve të tjerë.

1. Arsyetimi dhe gjetjet:

Gjatë vlerësimit të hollësishëm të të gjitha provave të paraqitura, trupi gjykues konsideroi provat e përmendura si në vijim dhe për qëllime mundësuese fakteve i është referuar si akuzës dhe nën akuzës së këtij aktgjykimi siç është identifikuar më lart.

Me qëllim që të përcaktojë nëse faktet janë vërtetuar apo jo duhet të nxirren në pah dy konsiderata hyrëse të përdorura nga trupi gjykues.

Së pari dhe si parim themelor, trupi gjykues konsideroi se nuk ka prova sipas ngjashmërisë. Kur një vepër penale është provuar e njëjta nuk mund të konsiderohet si asgjë më shumë sesa një tregues apo dyshim se një vepër penale e ngjashme mund të jetë kryer në rrethana të ngjashme.

Së dyti, masat e fshehta u konsideruan nga trupi gjykues si mjet i kërkuar për të mbledhur prova. Megjithatë, transkriptimet e përgjimeve duhet të jenë të besueshme në përmbajtjen e tyre përse i përket thelbit të referuar të fakteve. Për këtë arsye, ato transkriptime mund të përdoren si prova— dhe vetëm nëse —ato shoqërohen nga prova të tjera të cilat konfirmojnë apo mbështesin thelbin e bisedës së zhvilluar. Çdo bisedë lidhur me aktivitetin kriminal e cila nuk shoqërohet nga prova mbështetëse nuk mund të vërtetohet asgjë përveç faktit që biseda është zhvilluar. Bisedat lidhur me aktivitet kriminal nuk përbëjnë në vetvete vepër penale.

Duke patur parasysh këto kritere, Gjykata vendosi si në vijim:

Përse i përket fakteve të referuara më lart për **nën-akuzën 1**, përmbajtjet e transkriptimeve të përgjimit të telefonëve lidhur me numrat e telefonëve të përfshirë konsiderohen si të mjaftueshme për të vërtetuar se Ok.A ishte përfshirë në bisedë si dhe gjithashtu edhe se ishte pjesë e e librit telefonik të analizuar dhe regjistrimit të thirrjeve telefonike. Raportet e policisë italiane vërtetojnë se kalimet e kufirit janë ndërmarrë nga individë të identifikuar kur ata janë raportuar të ishin arrestuar në Trieste nga policia italiane në një periudhë kohore e cila përkon me bisedën telefonike. Në fund, biseda e hollësishme lidhur me të hollat identifikon qëllimin e aktiviteteve të Ok.A në këto biseda. Duke konsideruar përmbajtjen e bisedës telefonike dhe ngjarjet të cilat rrodhën nga biseda, faktet janë konsideruar si të besueshme dhe prandaj, në gjendje të mbështesin akuzat. Konsiderohet se nuk ekziston asnjë spjegim tjetër i arsyeshëm për të justifikuar aktivitetet e të pandehurit dhe në këtë mënyrë nuk rezulton dyshim i arsyeshëm nga ato.

Nga ana tjetër, transfertat e të hollave të cilat janë vërtetuar se vijnë nga FLA ose nga Bu.F nuk kanë lidhje të vërtetuar me kontrabandimin e këtyre 3 individëve. Ato mund të lidhen me çdo lloj operacioni tjetër, të ligjshëm apo të paligjshëm, të mëparshëm apo të mëvonshëm apo edhe me

subjekte të ndryshëm. Nga këto transfertat nuk mund të dëshmohet asnjë lidhje me 3 individët e kontrabanduar meqenëse nuk është bërë asnjë referencë këtyre transfertave në bisedat e përgjuara as Fl.At apo/dhe Bu.Ft, dhe nuk mund të përcaktohet korrespondenca e vlerave.

Përsa i përket **nën-akuzës 2**, ka prova të siguruara nga raportet e policisë slovene se dy personat e përmendur më lart kanë tentuar të kalojnë kufirin për në Itali, si dhe disa komunikime telefonike jo-përfundimtare me Ok.A. Megjithatë nuk janë siguruar prova se është rënë dakord për një përfitim material me Ok.A dhe nuk është paraqitur asnjë provë që lidh Ok.A me Bu.Fn dhe me transfertat e të hollave të lehtësuara nga ky i pandehur. Një spjegim i siguar nuk është asgjë përveç se një spekulim në bazë të kohës së këtyre transfertave dhe nuk ka patur as edhe një telefonatë të vetme me Ok.A ku mund të bazohet ai spjegim. Lidhur me Fl.An nuk ka fakte që lidhen me të cilat mund të çonin në akuzimin e tij me këtë nën-akuzë.

Lidhur me **nën-akuzën 3**, përmbajtja e bisedave të përgjuara është e hollësishme dhe tregon numrin e telefonatave të shkëmbyera mes të pandehurit Ok.A dhe migrantëve si dhe mes Ok.A dhe Bu.Ft. Raporti i policisë slovene përbën gjithashtu një aspekt të besueshëm të provave. Përmbajtja e përgjimeve telefonike ekspozon çmimet mbi të cilat ishte rënë dakord gjë e cila konfirmon qëllimin e të pandehurve për të pasur përfitim material si dhe pagEs.e bëra nga Bu.F, pavarësisht faktit se operacioni i kontrabandimit ishte i pasuksesshëm. . Fl.A sërish nuk përfshihet në asnjë nga provat e paraqitura.

Lidhur me **nën-akuzën 4**, ka prova të mjaftueshme për të lidhur Ok.A me emigrantët në fjalë, duke lidhur përmbajtjen e qartë të thirrjeve telefonike të përgjuara dhe SMS-in dërguar atij që korrespondon me të hollat dërguar përmes Western Union nga i njëjti dërgues. Biseda ishte përgjuar kur migrantët ishin tashmë me sukses në Itali e cila mund të spjegojë vetëm se në këtë rast operacioni i kontrabandimit ishte i suksesshëm. Të gjitha transfertat e të hollave të mëparshme dhe ato shoqëruese ku përfshihej Bu.F nuk mund të lidhej në mënyrë të mjaftueshme me aktivitetin e kontrabandimit të detajuar këtu. Përsa i përket Fl.A nuk ka lidhje të vërtetuar me këto fakte.

Lidhur me **nën-akuzën 5**, përveç përgjimeve, nuk janë paraqitur prova të tjera me qëllim që të konfirmohet përmbajtja e fakteve subjekt i asaj bisede.

Lidhur me **nën-akuzën 6**, përmbajtja e bisedave mes Ok.A dhe Ah. C dhe mes Ok.A dhe Bu.Ft demonstroi një plan kontrabandimi me qëllim të përfitimit material (diskutoheshin çmimet) dhe Bu.F duke u udhëzuar drejtpërdrejt përmes telefonit lidhur me këta migrantë. Biseda të tilla nuk ekzistojnë me FLAn, megjithëse vërtetësia e një plani të tillë është konfirmuar përmes mesazheve SMS dërguar nga Ok.A edhe FLAt dhe Bu.Ft. Megjithatë, përsa i përket FLA, faktet janë të pamjaftueshme për të konsideruar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm FLAn si të përfshirë në plan.

Lidhur me **nën-akuzën 7**, gjithë përmbajtja e përgjimeve është konfirmuar nga fakti se migrantët kishin kaluar me sukses kufirin për në Itali dhe ishin kapur në Itali dhe ishin kthyer në Kroaci dhe pastaj në Turqi më datë 13 dhjetor 2011. Biseda të mëtejshme telefonike nuk do të kishin kuptim nuk do të kishte ndodhur kalimi i kufirit. Si e tillë, është konfirmuar materializimi i fakteve.

Sa i përket **nën-akuzës 8** nuk ka prova të tjera përveç vetë bisedës së përgjuar. Nuk janë siguruar prova të tjera për të konfirmuar materializimin e fakteve të pretenduara.

Baza dhe arsyetimi për **Akuzën 3** është identik me atë të nën-akuzës 8 më lart: nuk ka prova të tjera konfirmuese për të arritur në përfundime të tjera lidhur përgjimet e vetme telefonike.

Lidhur me **Akuzën 4** ka një mënyrë të provuari të hollësishme por jo të konfirmuar: thirrjet telefonike të përgjuara. Sërish, Gjykata konsideron këtë si të pamjaftueshme për të vërtetuar faktet e pretenduara, pavarësisht se sa të hollësishme janë ato.

Lidhur me **Akuzën 1** provat e paraqitura në gjykatë lidhur veçanërisht kryerja e pretenduar e një serie krimesh në mënyrë homogjene— kontrabandimi i migrantëve— nga një seri të pandehurish në bashkëveprim me njëri tjetrin. Megjithatë provat e paraqitura kanë çuar në një seri bashkëveprimi mes Ok.A dhe Bu.Ft por jo në mënyrë bindëse me FLA për të cilin nuk janë

paraqitur prova të konsiderueshme për të lidhur atë me akuzat. Janë vërtetuar disa lidhje të tjera relevante mes Ok.A dhe Bu.Ft, mes Ok.A dhe individëve të tjerë si dhe mes Bu.Ft dhe individëve të tjerë. Megjithatë këto lidhje nuk mund të jenë as afër përcaktimit të një grupi homogjen. Bisedat zbulojnë një marrëdhënie thjesht biznesi ku përcaktohen kushtet, *modus operandi* dhe çmimet mes individëve dhe jo udhëzimet e siguruar brenda një grupi, apo mes celulave të të njëjtit grup. Mund të jetë e mundur që disa individë të kenë lidhje me njëri tjetrin por asnjë prej tyre nuk konsiderohet të jetë pjesë e të njëjtit grup si Ok.A dhe Bu.F. Prandaj, janë paraqitur prova për të treguar se disa grupe kanë bashkëvepruar si të tillë por konsiderohet se nga të pandehurit vetëm Ok.A dhe Bu.F kanë vepruar si pjesë e të njëjtit grup duke mbajtur kontakte me Turqinë apo me individë në Bosnjë, Kroaci dhe Serbi.

Lidhur me **Akuzën 5**, Gjykata ka analizuar të gjitha provat e paraqitura dhe ka arritur në përfundimin se të gjitha veprimet e ndërmarra mes individëve— apo edhe grupeve— të përfshirë vetëm zbulojnë një mënyrë të maskuar të fshehjes së pagesave reale për aktivitete ilegale, dhe jo një aktivitet transferimi prone me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, lëvizjes apo pronësisë së pasurisë. Në rastin në fjalë, Gjykata konsideron se çdo transfertë nuk mund të ketë qëllim tjetër përveç të transferimit të pasurisë, siç pretendohet thjesht si mënyrë pagese.

Prandaj, çdo veprim i dërgimit apo pranimit të hollash nga Ok.A dhe Bu.F — kur lidhet drejtpërdrejt me veprat penale — nuk mund të konsiderohet me ndonjë qëllim tjetër përveç rezultatit të zakonshëm nga aktiviteti i tyre kriminal i cili është pjesë e biznesit dhe, në terma ligjorë, nga përfitimi material paraparë nga dispozita ligjore. Për më tepër jo të gjitha transfertat e vërtetuara mund t'i referohen periudhës kohore gjatë së cilës pretendohen aktet e kontrabandimit (nga 25 qershor 2011). Të gjitha transfertat e tjera lidhen me akte jo të detajuara në aktakuzë lidhur me individët.

Megjithatë, lidhur me Bu.Fn dhe në mënyrë të veçantë përsa i përket FLAt, duhet të bëhen dy vërejtje lidhur me provat: nga njëra anë lidhur me Bu.F, nuk është konsideruar asnjë lidhje

direkte si e provuar mes shumave të transferuara dhe aktivitetit të kontrabandimit; nga ana tjetër, lidhur me FLA, pa patur parasysh shumat shumë të mëdha të përfshira në tërësi, lidhur me periudhën kohore specifike të kontrabandimit siç është provuar në këtë rast, bëhet fjalë vetëm për 3 transfertë (3,150.00 euro më datë 3 qershor 2011, 200.00 euro më datë 30 nëntor 2011 dhe 179.00 euro më datë 8 dhjetor 2011), megjithëse jo të lidhura me aktet e kontrabandimit respektivë, Gjykata i konsideroi ato si pothuaj jo domethënës, dhe për këtë arsye të pamjaftueshme për sa i përket të vlerës provuese.

Bazat ligjore:

Për arsye operative të cilat do të shpjegohen më poshtë, ky aktgjykim do të konsiderojë bazat ligjore të Akuzës 1 pas marrjes në konsideratë të të tjerave. Prandaj, lidhur me,

a) Akuzat 2, 3 e 4

Në nenin 138, KPK (2003) thuhet,

(1) Kushdo që merret me trafikimin e migrantëve dënohet me burgim prej dy deri dymbëdhjetë vjet.

(2) Kushdo që prodhon, prokuron, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimin të marrjes me trafikim me migrantë dhe për të fituar drejtpërdrejt ose tërthorazi dobi pasurore a financiare dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(3) Kushdo që personit i cili nuk është banor i Kosovës i mundëson të qëndrojë në Kosovë ose personit i cili nuk është banor vendor a i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.

(4) tentativa për të kryer vepër nga paragrafi 3 i këtij neni është e dënueshme.

(5) Kushdo që organizon ose urdhëron personat e tjerë për të kryer vepër penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 dënohet me gjobë deri 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri njëzet vjet.

(6) nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga kryerësi si anëtar i grupit ose në një mënyrë e cila rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetët a sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor a degradues duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, ai dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

(7) Sipas këtij neni,

1) Shprehja "kontrabandim me migrantët" do të thotë prokurim me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore a financiare i një hyrjeje të paligjshme të personit në ... një shtet person i cili nuk është banor i përhershëm apo shtetas.

2) Shprehja "hyrja e paligjshme" do të thotë ... kalim i kufirit të një shteti pa respektuar kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet.

3) Shprehja "dokument i rrejshëm i udhëtimit ose i identifikimit" do të thotë çfarëdo dokumenti identifikimi apo udhëtimi:

(i) që është falsifikuar ose ndryshuar në ndonjë mënyrë të caktuar nga cilido person pos nga personi ose organi i autorizuar në bazë të ligjit për të prodhuar ose lëshuar dokument udhëtimi ose identifikimi;

(ii) Që është lëshuar ose është siguruar në mënyrë jo të duhur përmes keqinterpretimit, korrupsionit ose trysnisë apo në çfarëdo mënyre tjetër të kundërligjshme; ose

(iii) që shfrytëzohet nga personi i cili nuk është mbajtësi i tij i vërtetë.

(...)

Përsa i përket të akuzuarit Ok.A dhe pasi janë marrë në konsideratë faktet të cilat janë konsideruar si të provuara, trupi gjykues konkludon se ai ka kryer kontrabandimin e migrantëve në nën-akuzat 1, 3, 4, 6 (tentativë) dhe 7 sepse:

(1) Mes datës 25 qershor 2011 dhe 6 korrik 2011 ai kontrabandoi Ha.D, Fe.Y dhe Av.S.Z, të gjithë shtetas turq duke u mundësuar, duke mos qenë shtetas dhe banorë të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore ku ata më vonë u arrestuan. Ok.A ka bërë referenca të qarta hollësive të udhëtimit, të hollave dhe pagesave në mënyrë direkte lidhur me kontrabandimin e këtyre 3 individëve të cilat përmbushin kushtet e vërtetimit të qëllimit ekzistues për të arritur një përfitim material që vinte nga ai aktivitet.

(3) Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 7 tetor 2011 Ok.A kontrabandoi Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri shënuar si S), qytetarë turq, duke u mundësuar atyre, duke mos qenë shtetas dhe banorë të përhershëm të Sllovenisë, të kalojnë kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore. Ai ishte siguruar me të dhënat e këtyre migrantëve, kishte rënë dakord me çmimin, udhëzoi migrantët me itinerarin e planifikuar, këshilloi ata lidhur me praninë e policisë (“*shumë policë në Zagreb*”), rezervoi një dhomë për ta në Porec; udhëzoi migrantët përmes Bu.Ft të hedhin pasaportat. Duke rënë dakord për çmimin për aktivitetin e përshkruar ai hyri në aktivitete sigurorese të lidhura direkt me qëllimin e sigurimit të përfitimit material nga ai aktivitet.

(4) Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 17 nëntor 2011, Ok.A kontrabandoi Za.A dhe Om.Y, qytetarë turq, duke u mundësuar, duke mos qenë shtetas apo banorë të përhershëm të Italisë, për të kaluar kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore. Ai ishte siguruar me të dhënat e këtyre migrantëve; më datë 15 nëntor 2011 ai foli me njërin prej këtyre migrantëve dhe pagEs.u diskutuan gjithashtu edhe me një individ me emrin “Ha.” dhe një pagesë u pranua nga Ok.A; migrantët kaluan kufirin në Itali rreth orës 16:41 më datë 16 nëntor 2011; të gjitha faktet përbëjnë kushtet ligjore të hyrjes në aktivitete prokurimi të lidhur me sigurimin e një përfitimi material nga ai.

(6) Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 nëntor 2011, Ok.A tentoi të kontrabandojë 4 migrantë në Beograd - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S, nga Serbia përmes Hungarisë në Austria duke pasur si qëllim që t’u mundësojë atyre, duke mos qenë shtetas apo banorë të përhershëm të Austrisë, të kalojnë kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore. Ai ishte siguruar me të dhënat e migrantëve, kishte rënë dakord mbi çmimin dhe kishte rregulluar transportin me shoferët. Nuk ka prova të paraqitura të cilat tregojnë se në fakt kalimi i kufirit ndodhi dhe si pasojë nuk ka provë të një përfitimi material të përfituar dhe për këtë arsye ky aktivitet mund të konsiderohet thjesht si tentativë, siç përcaktohet nga neni 20.1 KPK.

(7) Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011, Ok.A kontrabandoi një familje që përbuhej nga nëna dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.një djalë tjetër turk, Ug., duke u mundësuar ata, duke mos qenë shtetas dhe banorë të përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa

respektuar kushtet e domosdoshme ligjore; ai ishte siguruar me të dhënat e këtyre migrantëve, ishte pajtuar mbi çmimin, kishte udhëzuar migrantët me itinerarin e planifikuar për të marrë një autobus nga Zagreb në Porec; dhe migrantët u kapën më vonë në Venecie më datë 5 dhjetor 2011 nga policia italiane dhe më vonë u kthyen në Turqi më datë 13 dhjetor 2011. Të gjithë elementët ligjorë janë të pranishëm, përkatësisht hyrja e paligjshme dhe sigurimi me qëllim të sigurimit të përfitimit material nga ai aktivitet.

Lidhur me të akuzuarin Bu.F, dhe duke marrë parasysh faktet të cilat janë konsideruar si të provuara, trupi gjykues konkludon se ai është angazhuar në aktin penal të kontrabandimit të migrantë me nën-akuzat 3, 6 (tentativë) dhe 7 sepse:

(3) Mes datës 1 tetor 2011 dhe datës 7 tetor 2011, në bashkëveprim me të akuzuarit e përmendur më parë, Bu.F kontrabandoi Me.S, Ra.S dhe Ah. (mbiemri i fundit shënuar si S), qytetarë turq, duke u mundësuar atyre, duke mos qenë shtetas dhe banorë të përhershëm të Sllovenisë, për të kaluar kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore, kur ai i raportoi Ok.A udhëtimin nga Poreci dhe ishte udhëzuar nga ai si dhe udhëzimet e migrantëve për të hedhur pasaportat dhe ka koordinuar shoferët. Ai ishte drejtpërdrejt i përfshirë në të njëjtin veprim siç është përshkruar më lart lidhur me Ok.A gjë e cila do të thotë se ai ka vepruar në bashkëveprim me të dhe për këtë arsye kërkEs.ligjore janë përmbushur plotësisht.

(6) Mes datës 20 nëntor 2011 dhe datës 28 Nëntor 2011, Bu.F, tentoi të kontrabandojë 4 migrantë për në Beograd - Ya.D, Bi.H.O, Ha.D, Me.S, duke pasur si qëllim t'u mundësojë atyre, duke mos qenë shtetas dhe banorë të përhershëm të Austrisë, të kalojnë kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore; Bu.F ishte informuar nga Ok.A mbi katër migrantët dhe ishte informuar mbi identitetin e njërit prej tyre me anë të një SMS i cili i ishte dërguar nga Ok.A; trupi gjykues konsideron se ai ka marrë pjesë në të njëjtin veprim në tentativë siç u përshkrua më lart.

(7) Mes datës 28 nëntor 2011 dhe datës 6 dhjetor 2011, Bu.F, në bashkëveprim me Ok.A, kontrabanduan një familje që përbëhej nga nëna dhe 5 fëmijë, një migrant turk me emrin Il.dhe një djalë tjetër turk, Ug., duke u mundësuar atyre, duke mos qenë shtetas dhe banorë të

përhershëm të Italisë, të kalojnë kufirin pa respektuar kushtet e domosdoshme ligjore; Bu.F organizoi shoferët nga Poreci në Udine; pagesa e Il.ka qenë në shumën prej 1,700.00 euro dhe shërbimi i shoferëve është rregulluar nga Bu.F me Sh.Mn; ai ka udhëzuar migrantët të hedhin pasaportat e tyre dhe prandaj ai ka marrë pjesë në mënyrë aktive në të njëjtin veprim si Ok.A që është përshkruar më lart, duke patur të njëjtat qëllime nga ai.

Trupi gjykues konsideron gjithashtu faktet si të provuara dhe nuk gjeti arsye për të konsideruar se dhënia e udhëzimeve një bashkëkryerësi është të organizojë ose të drejtojë një person tjetër të kryejë veprën si rrethanë rënduese e vërtetuar, siç kërkohet nga ligji (neni 138. 5 KPK).

Duke marrë në konsideratë faktet siç janë konsideruar të vërtetuara dhe jo të vërtetuara, trupi gjykues konkludon gjithashtu se nuk ka fakte të mjaftueshme për të integruar veprën penale të kontrabandimit me migrantë siç është përshkruar në Akuzat 3 dhe 4. I njëjti konkludim vlen edhe për nën-akuzat e tjera (2, 5 dhe 8).

b) Akuza 5

Në përputhje me periudhën kohore e cila pretendohet në aktakuzë, aktiviteti i pastrimit të parave mbulohet nga dy ligje pasuese, përkatësisht neni 10.2 I rregullores së UNMIK-ut 2004/2, datë 5 shkurt 2004 dhe neni 32 i ligjit 03/L-196 datë 3 shtator 2010, dekretuar më datë 18 tetor 2010.

Gjykata konsideron se, duke marrë në konsideratë provat e paraqitura dhe periudhën kohore lidhur me veprat penale të vërtetuara, vetëm ligji i fundit mund të jetë i vlefshëm në këtë rast. Megjithatë, është e rëndësishme të shënohet se përmbajtjet e dy mjeteve legjislative nuk janë në thelb të ndryshme nga njëra tjetra.

Në Nenin 32.2 dhe 3, Ligji mbi Pastrimin e Parave (Ligji 03/L-196) thuhet,

2. Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës:

- 2.1. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit së natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;
- 2.2. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në to se që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij/saj;
- 2.3. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të shmangies së detyrimit të raportimit sipas këtij ligji;
- 2.4. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal; apo
- 2.5. merr, posedon ose shfrytëzon apo përpiqet të marrë, posedojë ose të shfrytëzojë pasurinë;
- 2.6. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;
- 2.7. merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 2.1. deri në 2.6. të këtij paragrafi,
- 2.8. Kryen veprë penale të dënueshme me një afat burgosjeje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale.
3. Për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni përfaqësimet mund të jenë bazë për të besuar se pasuria e caktuar përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale, madje edhe nëse ato përfaqësimet vetëm tërthorazi mbështesin besimin se ajo përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale.
- (...)

Trupi gjyqës konsideron se përse i përket disa pagesave të cilat mund të konsiderohen si të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e kontrabandimit të migrantëve, se nuk do të ishte bërë asnjë transfertë pasurie, por në vend të kësaj një mënyrë tjetër për të bërë pagesë për një biznes ilegal. Vërtet, transfertat e pronës pjesë e aktiviteteve të paligjshme është pjesë e biznesit (kontrabandimi i migrantëve) dhe jo mënyrë fshehjeje apo maskim i natyrës, burimit, vendndodhjes, lëvizjes apo pronësinë e pasurisë. Për këtë arsye, duke konsideruar pagesën si *conditio sine qua non* i njëjti aktivitet nuk do të kishte ndodhur, trupi gjyqës konsideroi se nuk është verifikuar asnjë transfertë pasurie ashtu siç kërkohet në kuptim të ligjit, dhe prandaj si veprë penale e veçantë.

c) Akuza I

Siç del nga një interpretim i kombinuar i nenit 274.7.1 deri 3 KPK, një Grup kriminal i organizuar ka 6 kushte ligjore:

- a) një grup prej tre apo më shumë personash;
- b) që nuk formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar;
- c) ekziston për një periudhë kohore;
- d) veprojnë në bashkëpunim;
- e) me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprash penale që dënohen me burgim me të paktën 4 vjet;
- f) me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt apo të tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.

Për këtë arsye, neni 274.1,2 dhe 3 KPK, për të cilën janë akuzuar të pandehurit— akuza 1 — penalizon sjelljen e mëposhtme megjithëse përcakton dënime të ndryshme për ta:

1. *Kushdo që kryen një krim të rëndë si pjesë e një grupi kriminal të organizuar ...*
2. *Kushdo që merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitete penale apo të tjera të një grupi të organizuar, duke ditur apo duke patur arsye të dijë se pjesëmarrja e tij do të kontribuojë në kryerjen e krimeve serioze nga grupi i organizuar kriminal ...*
3. *Kushdo që organizon, mbikëqyr, menaxhon apo drejton aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal ...*

Këto 3 sjellje alternative përfshijnë respektivisht: a) të jesh pjesë e një grupi të organizuar kriminal (GOK) DHE kryerja e një vepre penale që dënohet me të paktën 4 vjet burgim; b) marrja pjesë në aktivitetet e GOK DHE thelbi i kësaj pjesëmarrje që ka për qëllim që të kontribuojë për një vepër penale që dënohet me të paktën 4 vjet (jo domosdoshmërisht të kryera); c) organizimi,

mbikëqyrja, menaxhimi apo drejtimi i një GOK (jo domosdoshmërisht që ka kryer tashmë vepra të tjera penale).

E njëjta vepër penale siç parashihet nga neni 283 I kodit të ri KPK që hyri në fuqi më datë 1 janar 2013, është më e thjeshtë.

Sjelljet e mëparshme siç parashihen nga neni 274.1 dhe 2 kanë humbur pavarësinë dhe tani janë të dyja të përfshira në nenin 283.1 KPK. Sjellja e tretë e përmendur ruan pavarësinë e saj por ndëshkimi i saj është modifikuar thelbësisht.

Megjithatë domethënia ligjore është ruajtur (neni 120.13 dhe 14 KPK) në tërësi e cila çon në kushte ligjore identike, ashtu siç janë detajuar më parë.

Pasi janë marrë parasysh faktet ashtu siç janë konsideruar sit ë vërtetuara dhe jo të vërtetuara, një fakt i vetëm është i mjaftueshëm për të konsideruar këtë vepër penale si jo ekzistuese. Pavarësisht konsiderimit të ekzistencës të një grupi me disa udhëzime të dhëna nga i pandehuri i parë atij të dytit në disa raste si dhe koordinimi i aktiviteteve mes grupeve ekzistuese të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve, nga lart poshtë apo anasjelltas, nuk ka prova të udhëzimeve apo drejtimeve të dhëna elementëve të tjerë përveç Bu.Ft në një mënyrë që mund të konsiderohet si marrëdhënie hierarkike e vërtetuar me Ok.A. Të gjitha udhëzimet e tjera u janë dhënë direkt migrantëve apo partnerëve të biznesit që u takojnë grupeve të tjera dhe që nuk varen nga e njëjta strukturë e cila nuk është provuar të përbëjë celula të të njëjtit grup kriminal. Për këtë arsye, elementi kryesor I 3 apo më shumë personave nuk është verifikuar në rastin në fjalë. Prandaj, meqenëse nuk ka një grup kriminal ekzistues, çdo udhëzim i vënë re nuk është relevant për këtë vepër penale të veçantë për të cilën janë akuzuar të pandehurit.

Dënimi:

Sipas nenit 3.2 të kodit të ri penale, KPK, aplikohet neni më i favorshëm, i cili përfshin llogaritjen e dënimeve dhe zbatimin e tij të duhur.

Sipas nenit 34.1 dhe 2 të kodit penal të mëparshëm, dënimet kanë tre qëllime të ndryshme kumulative: të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të rehabilitojë atë dhe të parandalojë dhe të parandalojë persona të tjerë për të kryer vepra penale. Neni 41 i kodit të ri penal, prezanton dy qëllime të reja që të konsiderohen në përgjithësi, së bashku me këto që sapo u përmendën.

Përsa i përket llogaritjes së dënimeve, neni 64.1 të KPK së mëparshëm ka përcaktuar kritere që duhet të merren parasysh dhe kufizimit si dhe rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese. Neni 73 I KPK të ri nuk përcakton një sistem të ndryshëm dhe duhet gjithashtu që rrethanat lehtësuese dhe rënduese duhet të merren parasysh në të njëjtën mënyrë.

Neni 71 I KPK të mëparshëm dhe neni 80 i kodit të ri penal përcakton të njëjtat kritere lidhur me dënimin.

Duhet të thuhet se asnjë nga regjimet e përcaktuara nuk mund të konsiderohen në mënyrë të përmbledhur dhe abstrakte si më të favorshëm apo të pafavorshëm për personin e dënuar. Ky aktivitet kryhet në bazë të rrethanave konkrete të përfshira.

Sipas nenit 138, paragrafi 1 KPK (2003) ai që merret me kontrabandimin e migrantëve *dënohet me burgim nga 2 deri 12 vjet*. Megjithatë nga paragrafi 6 I të njëjtit nen del në pah një çështje: *“kur vepra që parashihet nga paragrafi 1... është kryer nga një kryerës që vepron si anëtar i një grupi apo në një mënyrë që rrezikon apo që ka gjasa të rrezikojë jetët apo sigurinë e migrantëve përkatës apo që përfshin trajtimin çnjerëzor a degradues ... kryerësi dënohet me burgin nga 2 deri 10 vjet”*. Thënë thjesht, rrethanat rënduese si ato do të “shpërbleheshin” me një dënim maksimal më të lehtë, gjë e cila domosdoshmërisht do të reflektohej në dënimin konkret të caktuar.

Duke ndjekur parimin e interpretimit më të favorshëm për të pandehurin si dhe parimin e ligjshmërisë (*nulla poena sine lege*) trupi gjykues nuk mund të konsiderojë në kodin e mëparshëm penal një dënim maksimal prej më shumë se 10 vjet burgim. Si pasojë, trupi gjykues është i detyruar të gjejë kodin e vjetër si domosdoshmërisht më të favorshëm se ai i riu.

Ndryshimi i vetëm I dënimit është reflektuar në ekzistencën e një gjobe shoqëruese, paraparë së bashku me të njëjtën kornizë minimale/maksimale të burgimit.

I pandehuri Ok.A ka marrë pjesë në mënyrë aktive në 5 akte të cilat mund të konsiderohen si përfshirje në kontrabandimin e migrantëve, një prej të cilave në tentativë. Duke marrë në konsideratë relevancën e pozitës së tij si kontakt relevant mes burimeve turke dhe vendeve të tjera të destinacionit final si dhe mes shteteve, relevanca e këtyre akteve për përfitimin personal pasues nuk mund të mos shikohet dhe Gjykata konsideron si thelbësisht të lartë edhe shkallën e tij të përgjegjësisë penale dhe dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Nga ana tjetër, rrethanat dhe motivet në të cilat janë kryer veprat janë vlerësuar si në një në një nivel të mesëm si një krim në vazhdimësi, pavarësisht se faktet e vërtetuara janë kryer gjatë kohës me intervale të ndërmjetme. Nuk janë vërtetuar dënime të mëparshme për vepra penale të kësaj natyre apo ndonjë natyre tjetër. Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana Gjykata konsideron se dënimi prej 7 (shtatw) vjetësh burgim është dënimi i përshtatshëm.

I pandehuri Bu.F ka qenë në kontakt me disa individë të tjerë, megjithëse jo të të njëjtit grup, por në lidhje të drejtpërdrejtë me Ok.A dhe në të paktën 3 raste.

Duke marrë parasysh relevancën e pozitës së tij si ekzekutues i drejtpërdrejtë dhe ndërmjetësues edhe me migrantët dhe guidat dhe shoferët e taksive, roli i tij është konsideruar si thelbësor për suksesin e aktivitetit të paligjshëm. Siç është vërtetuar përfitimi nuk është i madh por Gjykata konsideron si thelbësisht të lartë edhe shkallën e përgjegjësisë së tij penale edhe dëmtimin e vlerës së mbrojtur. Nga ana tjetër, rrethanat dhe motivet në të cilat janë kryer veprat janë vlerësuar si në një nivel të mesëm. Një dënim i mëparshëm është pretenduar por që nuk është vërtetuar. Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana Gjykata konsideron dënimin prej 3 (tre) vjetësh burgim si dënim të përshtatshëm.

Konfiskimi:

Prokurori i PSRK-së pretendon se përfitimi material i të pandehurit është ai siç është listuar dhe prandaj këto shuma duhet të konsiderohen si asete të cilat janë siguruar për shkak të veprimeve të cilat përbëjnë vepër penale.

Pavarësisht faktit se shumica e madhe e këtyre shumave nuk janë lidhur drejtpërdrejt me faktet përmes provave të vlefshme, trupi gjykues konsideroi këto shuma si të tilla nuk përputhen me asetet kur ato nuk janë sekuestruar kurrë më parë dhe të cilat tani ekzistojnë thjesht si shuma reference. Trupi gjykues vendos të mos marrë parasysh nëse këto shuma parash ekzistojnë akoma tani dhe një listë përfitimesh të pretenduara nuk është objekt material që mund të konfiskohet. Trupi gjykues nuk mund të vendosë të konfiskoje një objekt kur ekzistenca e tij aktuale është e papërcaktuar.

Megjithatë, sipas Nenit 276 KPPK, dy aparatet telefonikë përdorur nga të pandehurit deklarohen të konfiskuar në mënyrë të përhershme.

Duke marrë parasysh të gjitha bazat e lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv.

Mjet ligjor: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë nga Prokuroria apo nga të pandehurit e dënuar, në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prizrenit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur palët kanë pranuar aktgjykimin e plotë me shkrim, sipas nenit 398, paragrafi 1 of KPPK, nëse është shpallur brenda 8 (tetë) ditëve në vijim nga data aktuale.

Prizren, 6 shtator 2013

Vitor Hugo Pardal

Kryetar i Trupit Gjykues

Christine Sengl

Procesmbajtëse